



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2148/10 Prot

Tiranë, më 29/06/2022

Lënda: Njoftim

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE Durrës

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 29.04.2022 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës”, shkresës nr.2148/1 prot, datë 08.06.2022 “Njoftim për vend të lirë pune” të AKPA-s dhe Vendimit përfundimtar të Komisionit të Vlerësimit me nr.2148/8 prot, datë 24.06.2022, për pozicionin e punës Përgjegjës Sektori në Sektorin e Programeve Aktive dhe Pasive, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Durrës (vetëm për periudhën kohore të lejes së barrë lindjes së punonjësës së emëruar në këtë pozicion), kategoria IV-a, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, ju njofton emërimin e kandidatit si më poshtë:

Emërimin në detyrë të z.Leonard Kapllani, në pozicionin e punës Përgjegjës Sektori në Sektorin e Programeve Aktive dhe Pasive, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Durrës (vetëm për periudhën kohore të lejes së barrë lindjes së punonjësës së emëruar në këtë pozicion), kategoria IV-a.

Njoftimi bëhet në faqen elektronike zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Durrës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klevis HYSA

